PROCESVERBAL

Nga seanca e këshillit të mbajtur me 29.12.2022, e enjte me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës, në prezencë të këshilltarëve dhe në prezencë të Kryetarit të komunës Blerim Sejdiu.

Seancën e 14-të(katërmbëdhjetë) e hapi Kryetari i këshillit Bujar Baftjari, dhe prezantoi rendin e ditës, që përbëhet nga 9 pika.

R E N D D I T E

1. Miratimi i Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.
2. Propozim-Vendim për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.
3. Propozim-Vendim për miratimin e propozim-planit të programeve për zhvillim për vitin 2023-të.
4. Propozim-Vendim për miratimin e kritereve për shpërndarjen e bllok dotacioneve për arsimin fillor për vitin 2023-të.
5. Propozim-Vendim për vërtetim të vlerës së poenit për rrogat e nënpunësave shtetëror për vitin 2023-të.
6. Miratimi i Kalendarit buxhetor për vitin 2024-të.
7. Shqyrtimi i kërkesës për korigjim dhe plotësimin e Çmimores për lartësin e çmimeve për shërbimin e grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbetjeve.
8. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim të Programës për punë dhe zhvillim të Ndërmarjes publike komunale ,,Mirëmbajtja'' – Zhelinë, f.Zhelinë për vitin 2023-të.
9. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim të Planit financiar të Ndërmarjes publike komunale ,,Mirëmbajtja'' – Zhelinë, f.Zhelinë për vitin 2023-të.

Pas prezantimit kryetari I këshillit Bujar Baftjari hapi hapi diskutim për rendin e ditës.

Fjalën e kërkoi këshilltari Bashkim Limani

Bashkim Limani: Kërkoj seancës t'I shtohet edhe një pikë. Propozim – Vendim për mbartjen e kompetencave dhe përgjegjësive për ekonomizimin me rrjetin e ujësjellësit shoqatës së qytetarëve Llukojca, fshati Llukovicë- Zhelinë.

Kryetari I këshillit propozimin e këshilltarit Bashkim Limani e hodhi në votim, ku me 2 vota për, asnjë kundër dhe 16 të përmbajtur, konstatoi se nuk kalon propozimi.

Më pas rendin e ditës e hodhi në votim, ku u votua unanimisht.

Pas votimit kryetari I këshillit e shpalli të hapur seancën e katërmbëdhjetë.

1.Miratimi i Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Kryetari I këshillit Bujar Baftjari hapi diskutim për pikën e parë.

Fjalën e mori këshilltari Nderim Tairi.

Nderim T: Unë si këshilltar I aleancës kërkoj që në buxhetin e vitit 2023 të përfshihen këto projekte: zgjerimi I rrugës që lidh fshatin Leshnicë e Poshtme me fshatin Zhelinë, ujësjellësin e fshatit Merovë, rrugaqë lidh fshatin Dëbërcë me fshatin Çiflik, rruga Stremnicë- Saraqinë, çerdhja dhe bulevardi në Zhelinë. Nëse jo realizimin e këtyre projekteve të paktën të përfshihen disa mjete për projektimin e tyre, që më vonë pas ca vitesh të realizohen. Uroj që këto kërkesa të merren parasysh përndryshe vota ime nuk do të jetë pro këtij buxheti.

Më pastaj fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Për këtë pikë unë kam disa dilema. Edhe para një viti, dhe nga ajo senacë publikisht kam kërkuar që buxheti I ardhshëm për vitin 2023 në atë kohë për këtë buxhet mos të jetë pa debat publik. Jemi e vetmja komunë që e paraqet buxhetin pa debat publik, pa njerëz të sferës përkatëse, ekonomistë që të mund të na ndihmojnë që mjetet financiare për buxhetin e vitit 2023 të destinohen te ata projekte që janë profitabile dhe që përmirësojnë kushtet e qytetarëve. Unë vjet votova I përmbajtur për arsyen se ai buxhet përmbante disa vlera(mjete) financiare që ishin destinuar në disa zëra që për mua ishin të paarsyeshme, ndërsa sot po të njëjtat mjete I shoh se janë të destinuara në ato zëra. Si këshilltar komunal kërkoj që ky buxhet sot të shqyrtohet dhe mjetet që kanë të bëjnë me ndriçimin publik, që kanë të bëjnë me punësimet e përkohshme të reduktohen ose të paktën për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, me që është edhe kryetari I komunës këtu prezent dhe të na jap sqarime se ku qëndron dallimi në mes ndriçimit publik që parashihet në zërin J30, në zërin JA0 ndërtimi I ndriçimit publik dhe prapë kemi në fond ndriçim publik me 10 milionë e 500 mijë denarë. Unë nuk e kam të qartë në bazë të kujt komuna e Zhelinës miraton buxhetin duke destinuar për ndriçim publik 8 milionë e 300 mijë denarë, ndërtim I ndriçimit publik 5 milionë e 450 mijë denarë dhe në total 10 milionë e 500 mijë denarë. Kjo sa I përketë vërejtjes që ka të bëj me mjetet financiare të destinuara për ndriçim publik. Nga kryetari I komunës kërkoj që të paktën të na numëroj tre projekte kapitale përmbyllëse për vitin 2022 që janë realizuar si rezultat I miratimit të buxhetit për vitin 2022.

Pas këshilltarit Sheval Sulejmani, fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Pasi jam në komisionin për financa desha të dijë nga administratori për financa të jap informacione më tepër për zërat 425 dhe 427?

Adil Emini: Dha sqarimet e duhura për këto pyetje. Ku tregoi se zëri 427 janë punësimet e përkohshme, janë të punësuarit me kontratë përmes agjensionit për punësim, kurse te zëri 425 janë shërbimet kontraktuese dhe kjo nuk nënkupton vetëm shërbimet e personave të angazhuar, aty futet edhe Programa F1- Përgatitja e Planeve Urbanistike.

Naser M :Te punësimet e përkohshme dua ta di sa ka të kontraktuar që punojnë në komunë?

Adil E: Nuk e mbaj mend por do ta sjell listën.

Kryetari I komunës Blerim Sejdiu vazhdoi: Sot kemi disa pika por si më të rëndësishme do ta veçoja çështjen e propozim miratimit të buxhetit për vitin e ardhshëm. Kur buxhetin e përcaktojnë të hyrat në komunën dhe kjo ta determinon pastaj edhe të gjithë realizimin e vitit të ardhshëm. Ne e dimë se si ka kaluar ky vit, çfarë ka ndodh dhe si e kemi orientuar buxhetin, duke nisur nga Ministritë nga Qeveria, ne ishim të obliguar që buxhetin ta orientojmë në çështje të pagesave. Ne nuk kemi pas të bëjmë investimi luksi, apo investime në bazë të programeve që I kemi paraparë apo kërkesat e qytetarëve apo dëshirat tona, për arsye se nuk na mundësonte buxheti. Ne programet I realizojmë në bazë të thirrjeve dhe të gjithë realizimet I bëjmë në bazë të shpalljeve që Ministritë apo Qeveria I bënë.

Ministritë që ne I presim prej vitit 2019/20 që të realizojmë rrugët I kemi përmbyll negociatat siç është Ministria e Transportit ku ne duhet të realizojmë rrugën Zhelinë rruga 2A, rrugën Pallaticë- Zhelinë. Sa I përket asaj se çfarë kemi realizuar për vitin 2022, ka qenë vit I vështirë por jo pa punë, ka pas realizime. Shkolla e fshatit Leshnicë u hap në vitin 2022 bashkë me Ministrinë e Arsimit kemi realizuar projekt të mirë të shumë pritur gati 20 vjet pritje për të. Pastaj përmbyllja e trotuareve dhe rrugëve në fshatin Stremnicë, poashtu janë duke u ndërtuar edhe pompat bashkë me rezervuarin. Pastaj ujësjellësi në Merovë e realizuam fazën e dytë, jemi në aplikim me një organizatë ndërkombëtare. Në bashkëpunim me fondet e Ministrisë së Ambientit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor ujësjellësi në fshatin Kapazhdoll është në fazë përfundimtare. Me UNDP-në jemi duke punuar murin mbrojtës në Leshnicë, po me UNDP-në bëmë pastrimin e disa përenjve, disa inverter te shkolla fillore në Trebosh në vlerë prej 50 000 euro. Për rikonstruimin e shkollës së Treboshit preim përgjigje nga Ministria, rruga në Trebosh do të niset. Për pyetje që më parashtroi këshilltari Nderim për zgjerimin e rrugës Zhelinë- Leshnicë, fokusi jonë tani është te kjo rrugë. Në Dëbërce do shkojmë në fazën e dytë të rregullimit të rrugëve brenda fshatit deri te xhamia. Strimnicë- Saraqinë kemi projekt. Edhe për çerdhen kemi projekt prej vitit 2018, për herë të parë mjetet I fituam në 2018 për ta ndërtuar në Zhelinë por hasëm ca probleme sepse parcela ku donim ta ndërtonim nuk ishte për çerdhe sipas ligjit, tani në muajin e 11 kemi aplikuar përsëri për çerdhen. Kemi përgatitur projekt për kanalizimin përfshatin : Dëbërcë, Çiflik, Rogle, Novo sellë dhe Grupçin, përveç kësaj ujësjellësin në Pallaticë nëse Ministria e Ambientit Jetësor në muajin e 4 ose 5 të hap shpallje për realizim të projektit ne do aplikojmë. Dhe lartë poshtë këto janë projektet. Ndërsa deponin e fshatit Dëbërcë për vitin 2023 konsiderojeni të pastruar.

Sheval S: Kryetari përmendi disa projekte që do të kisha thënë që janë vetëm simbolike krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar. Në fillim të mandatit kryetari pati premtuar e çeki vet rrugën te xhamia në Dëbërcë dhe tha që mjetet janë miratuar por fatëkeqësisht nuk është realizuar, ndërsa aspak nuk dha sqarime për ndriçimin publik. Kërkoj me çdo kusht që për punën e ndriçimit publik në ankandin e shpallur që keni kontratë, dua ta di se në cilën kompani destinohen mjetet. Të më sigurohet nëse është e mundur një kopje e kontratës me kontraktuesin e mirëmbajtjes së ndriçimit publik.

Adil E: Dha sqarime të detajuar për to, ku tha se te ndriçimi publik na paraqiten dy programe J3 dhe JA.

Sheval S: Unë kam bë një qasje në pagesat që realizohen nga ana e komunës, ka pagesa që bëhen me padi nga ana e EVN-së dhe pagesa që I bënë enkas ndërmarrja për ndriçim publik. Nëse keni nënshkruar marrëveshje që kapën shumën 8 milionë e 300 mijë, hajde ulemi dhe ta reduktojmë këtë vlerën, sepse vlera e ndriçimit 10 milionë e 300 mijë denarë është e barabartë me vlerën që shihet në rikonstruktimin e rrugëve dhe rrugicave lokale. Nëse do reduktohet shuma e vlerës për ndriçim publik, mendoj se shumë projekte të tjera do realizohen për të mirën e qytetarëve.

Adil E: Dha sqarime

Naser M: Shoh një projekt që nuk ka të bëjë aspak me komunën e Zhelinës, ndërtimi I rrugës në fshatin Çajle te konti JDB.

Adil E: Është gabim teknikë.

Nderim T: Para se të hudhet në votim kjo pikë nëse ka mundësi të na jepen dokumentacionet e këtyre projekteve që kryetari tha se I ka siguruar, ose ta lëmë për më vonë apo për një ditë tjetër këtë pikë.

Kryetari I këshillit Bujar Baftjari kërkoi 20 min pauzë për t'u siguruar dokumente e nevojshme që kërkoi këshilltari Nderim.

Pas pauzës Kryetari i këshillit Bujar Baftjari e hapi seancën dhe vazhdoi: Pasi u dhanë sqarimet e nevojshme për buxhetin e vitit 2023, po pyes përsëri nëse ka dikush të shtoj diçka.

Fjalën e mori këshilltari Naser M.

Naser M: Unë si këshilltar do ta votoj buxhetin por të ketë reduktime tek punësimet e përkohëshme.

Pas këshilltarit Naser fjlën mori këshilltari Rian Amiti.

Rian A: Te kontratat shihet se të gjithë janë të punësuar në punë të tjera përveç disave, pastaj kryetari përmendi pastrimin e deponive, kryetari edhe para një viti tha se deponit do të pastrohen.

Kryetari i komunës Blerim Sejdiu tha: Në vitin 2022 janë pastruar deponit në: Trebosh, Pallaticë, Strimnicë, Grupçin, Zhelinë rreth lumit Vardar, Cerovë dhe Novosellë. Dëbërca nuk përmendet për vitin 2022.

Rian A: Në fshatrat malor pate përmendur se njëherë në muaj do të merren mbeturinat. Çfarë dite janë marr?

Sheval S: Para se të hudhet në votim kjo pikë kërkoj që të bëhen disa reduktime që i diskutaum më herët, të sigurohet kontra me kontraktuesin për ndriçim publik, konto 427.

Pas diskutimit Kryetari i këshillit pikën e parë: Propozim buxhetin për vitin 2023 bashkangjitur me kërkrsën për reduktim në konton 427 e hudh në votim. Me 12 vota për, asnjë kundër dhe 6 të përmbajtur, konstatoi se kjo pikë kalon.

Më pas Kryetai i këshillit vazhdoi: Kemi një sitaut të re të krijuar në të cilën në koordinim me koordinatorët që të shtohet një pikë e rendit të ditës: Kemi Vendim për qëllimin e shfrztëyimit të obligacioneve struktusore për sigurimin e mjeteve financiare për financimin e obligimeve të arritura të papaguara. Kush është për këtë që të shtohet si pikë e rendit të ditës.

U hodh në votim, ku u votua unanimisht.

Kryetari i këshillit hapi diskutim për këtë pikë. Fjalën e kërkoi këshilltari Sheval Sulejmani.

ShevalS: Kërkoj sqarim për këtë pikë?

Sqarimet i dha administratori Adil Emini.

Pastaj sqarime dha edhe Kryetari i komunës Blerim Sejdiu ku tha: Ministria e Finacave na jep një mundësi që kompanive që ju kemi borxh t'ju japim një flet obligacion me të cilin ajo konvertohet dhe

njihet edhe si mjet financiar, me atë do të konsiderohet se kemi la borxhin ndaj tyre, pastaj ne si komunë do të kemi punë me Ministrinë e Financave.

Pas sqarimeve Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht, dhe konstatoi si kjo pikë u miratua.

3. Propozim-Vendim për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2023-të.

Për këtë pikë Kryetari i këshillit hapi diskutim, meqë nuk u diskutau e hodhi në votim, ku me 15 vota për, asnjë kundër dhe 3 të përmbajtur konstatoi se kalon.

4. Propozim-Vendim për miratimin e propozim-planit të programeve për zhvillim për vitin 2023-të.

Te kjo pikë nuk pati diskutim, kryetari i këshillit e hodhi në votim. U votau nga të gjithë këshilltarët përveç këshilltarit Riana Amiti i cili tha se e abstenon në këtë pikë. Kryetari i këshillit pas votimit knostatoi se kjo pikë kalon.

5. Propozim-Vendim për miratimin e kritereve për shpërndarjen e bllok dotacioneve për arsimin fillor për vitin 2023-të.

Kryetari i këshillit për këtë pikë hapi diskutim. Fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Për këtë pikë desha të parashtroj një pyetje në buxhet gjithmonë parashihen mjete dhe dodacione konsiderohen si të paprekshme dhe në anën tjetër ndodh që shkollat të mos kenë nxemje, mos kenë lëndë djegëse. Pse ndodh kjo?

Kryetari i komunës Berim Sejdiu u përgjigj: Po janë të paprekshme dhe është vetëm transferimi përmes komunës, por në pyetjen e parashtruar të them se ajo që thua ti ka ndodh vetëm në shkollën "Pashko Vasa" në Grupçin për arsyen se ajo shkollë e ka xhirollogarin e bllokuar.

Pas sqarimeve kjo pikë u hodh në votim, ku me 17 vota për, asnjë kundër dhe 1 të përmbajtur Kryetari i këshillit konstatoi se kjo pikë kalon.

6. Propozim-Vendim për vërtetim të vlerës së poenit për rrogat e nënpunësave shtetëror për vitin 2023-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim, nuk u diskutua. E hodhi në votim, ku u votua unanimisht dhe konstatoi se kjo pikë kalon.

7. Miratimi i Kalendarit buxhetor për vitin 2024-të.

Kryetari i këshillit pas nuk pati diskutim kjo pikë e hodhi në votim, ku me 16 vota për, asnjë kundër dhe 2 të përmbajtur, konstatoi se kalon.

8. Shqyrtimi i kërkesës për korigjim dhe plotësimin e Çmimores për lartësin e çmimeve për shërbimin e grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbetjeve.

Kryetari i këshillit hapi diskutim. Fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Sa i përket kërkesës që kompania për grumbullimin e mbeturinave kërkon ngritjen e çmimit, unë si këshilltar komunal propzoj për këtë pikë të rendit të ditës të diskutohet seancën e radhës me obligim që Kryetari i komunës të angazhoj nga një përfaqësues të bashkësive lokale nga të gjitha vendbanimet këtë e them në mënyrë që të shpërndahet përgjegjësia. Përfaqësuesi i kompanisë në fjalë edhe ai deri diku ka të drejtë sepse ka paraqitur dëshmi, ka paraqitur dokument se janë rritur çmimet nga ana e kompanisë Rusino ku bëhet deponimi i mbeturinave, mirëpo për këtë duhet të organizohet një debat më i gjërë sepse nuk është vendim që duhet ta sjellim vetëm ne por të informohen edhe ata që ceka më lartë, që t'i gjejmë një zgjidhje.

Kryetari i këshillit Bujar Baftjari tha: Atëhere votojmë që kjo pikë të diskutohet në seancën e radhës me propozim që Kryetari i komunës të ftoj Bashkësitë Lokale me pronarin e kompanisë që të gjejnë zgjidhje.

U hodh në votim dhe u votua unanimisht.

9. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim të Programës për punë dhe zhvillim të Ndërmarjes publike komunale ,,Mirëmbajtja'' – Zhelinë, f.Zhelinë për vitin 2023-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim. Fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Për këtë pikë kam një dilem e shoh që në pikën 2 të programës përmendet plotësim ndryshim i dokumentacionit teknikë ekzistues për ujësjellësin dhe kanalizimet për të gjitha vendbanimet e komunës së Zhelinës. Këtë e bënë Komuna apo Ndërmarrja Komunale?

Kryetari i komunës Blerim Sejdiu u përgjigj: Mirëmbajtja ka përgatitur projekte, ka porositur nga kompanitë projektuese për realizim të ndonjë ujësjellësi, besoj se për këtë bëhet fjalë.

Më pas fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi

Naser M: Është mirë ndërmarrja ta zgjidh problemin e rrymës së pompës së fshatit Grupçin nëse ka kompetencë.

Më pas e mori fjalën këshilltari Rian Amiti.

Rian A: Tek mirëmbajtja dimërore jo se bëhet mirëmbajtja e rrugës edhe verës, po për dimrit, tash është fillimi i jananrit ende zallë dhe kripë nuk është dërguar në viset malore. Vitin e kaluar është dërguar pas 20 janarit. Këtë vit t'i dërgoni më herët që të mos ju kap bora në befasi.

Kryetari i komunës tha sqarime.

Rian Amiti vazhdoi: Me iniciativën e rinisë vjet rrugët janë mirëmbajtur.

Pas sqarimeve Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht nga gjithë këshilltarët. Kryetari i këshillit konstatoi se kjo pikë kalon.

10. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim të Planit financiar të Ndërmarjes publike komunale ,,Mirëmbajtja'' – Zhelinë, f.Zhelinë për vitin 2023-të.

Kryetari i këshillit hapi diskutim. Fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.

Naser M: Tek kompenzimet për antarët e këshillit udhëheqës dhe mbikëqyrës, unë kam fol edhe me drejtorin e ndërmarrjes. Këtu thuhet se ka realizuar seanca, por antarët që i kam caktuar unë nuk janë thirrur në asnjë seancë. Këtu janë shënuar ca shifra se janë realizuar. Ç'do të thotë kjo?

Këtu do ishte mirë të ishte drejtori i ndrëmarrjes prezent për të dhënë sqarime.

Drejtori nuk mund të ishte prezent në këtë senacë.

Kryetari i këshillit Bujar Baftjari pas diskutimit këtë pikë e hodhi në votim, ku me 1 votë për, asnjë kundër dhe 16 të përmbajtur konstatoi se kjo pikë nuk kalon.

Pas kësaj Kryetari i këshillit e shpalli të mbyllur seancën e katërmbëdhjetë.

Nr.08-1791/2
29.12.2022-të
Zhelinë

Procesvebalist
Albineta Alija

Këshilli i komunës së Zhelinës
Kryetar
Bujar Baftijari